



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/1255
Data e Vendimit: 31.12.2025

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, si dhe nenit 17 paragrafi 6 i Rregullores së punës së OSHP-së nr. 01/2020, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik “HM Home” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale - Ritender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – “KOMUNA PRISHTINË” zv. Kryesuesi i Organit Shqyrtues të Prokurimit me datë 30.12.2025, mori këtë:

Vendim

I. Hedhet si e palejuar, ankesa e “HM Home” SH.P.K. me nr. të protokollit 2025/1255, e datës 22.12.2025, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) - “KOMUNA PRISHTINË”.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues “KOMUNA PRISHTINË” që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ritender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

III. Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Organi Shqyrtues i Prokurimit në sistemin elektronik me datë 22.12.2025, ka pranuar ankesën me Nr. Protokolli 1255/2025 nga OE “HM Home” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ri-tender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, në cilësinë e Autoriteti Kontraktues.

Me 25.07.2025 “KOMUNA PRISHTINË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B05-Njoftimin për Kontratë, ku sipas këtij njoftimi Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data: 05.08.2025. Ndërsa me datën 19.12.2025 ka publikuar B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara, ku afati i fundit ka qenë me datën 22.12.2025.

OE “HM Home” SH.P.K. me 19.12.2025 OE ka bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së. Ndërsa me datë 22.12.2025 AK e ka hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për Rishqyrtim.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ri-tender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, iniciuar nga “KOMUNA PRISHTINË” njoftimi për kontratë është publikuar në sistemin e prokurimi me datë 25.07.2025, Afati i fundit për pranim të tenderëve ka qenë data: 22.12.2025.

Ndërsa me datë 19.12.2025 OE “HM Home” SH.P.K. kishte bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK- së. Autoriteti Kontraktues me datë 22.12.2025 e ka hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për Rishqyrtim.

Ankuesi ka qenë i obliguar që në pajtim me paragrafin 3.1 të nenit 108/A të LPP-së, brenda afateve ligjore të parashtror kërkesë për rishqyrtim në AK dhe vetëm pas udhëheqjes së procedurave paraprake në AK, Operatori ekonomik në pajtim me nenin 109 të LPP-së do mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Neni 108/A paragrafi 3.1 i LPP-së përcakton se operatori ekonomik ankues kërkesën për shqyrtim duhet të dorëzoj tek autoriteti përkatës kontraktues: “..në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Po ashtu, edhe neni 60.1 pika a) në Rregulloren 001/2022 për Prokurim Publik përcakton se: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas nenit 63.1.1 të kësaj rregulloreje...”. Andaj nga provat e prezantuara dhe rrjedha e këtij aktiviteti të prokurimit konstatohet se ankesa e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me datë 22.12.2025 nga OE “HM Home” SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ri-tender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, iniciuar nga “KOMUNA PRISHTINË” hedhet e palejuar sepse e njëjta nuk është parashtruar në pajtim me nenin 108/A të LPP-së si dhe nenin 60 par.1 të Rregullores për Prokurim Publik. Po ashtu referuar interpretimit të KRPP-së të datës 07.11.2023, nr 630/2023, i cili interpretim sqaron afatet ligjore për ankimim, konstatohet se kjo ankesë hedhet si e pa lejuar sepse ankuesi nuk ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim brenda afateve ligjore kundër njoftimit të Autoritetit Kontraktues ka parashtruar KR me datë 19.12.2025 e cila me datë 22.12.2025 AK e ka refuzuar e ka hedhur poshtë si të pasafatshme kërkesën për Rishqyrtim.

Megjithatë Organi Shqyrtues i Prokurimit sqaron se vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake të rregullt dhe brenda afateve ligjore pranë AK, ankuesi mund ti drejtohet me ankesë OSHP-së. Si përfundim kjo ankesë është në kundërshtim me nenin 108/A, 109 dhe të Ligjit për Prokurim Publik, dhe nenit 60 të Rregullores 001/2022 për Prokurim Publik, dhe si e tillë hedhet si e pa lejuar dhe nuk hynë në shqyrtim nga OSHP. Megjithatë, OSHP gjithnjë niset nga rregullat, zgjidhjet dhe parimet e LPP sipas të cilit secili AK ushtron pavarësinë e tij/sajë në kuptim të nenit 8 dhe 9 lidhur me planifikimin e prokurimit dhe parashikimin e nevojave, mirëpo kriteret e parapara gjithnjë duhet ta garantojnë barazinë e OE të cilët parashihen si të tillë edhe me DT e cila në kuptim të nenit 27, lidhur me nenin 28, përbën dokumentin kyç të prokurimit publik. Prandaj në kuptim të nenit Neni 51 (Njoftimi i Kritereve të Përzgjedhjes) të LPP, sipas të cilit të gjithë kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar se vetëm operatorët ekonomik që posedojnë aftësitë e nevojshme profesionale, financiare dhe teknike për ti përmbushur kushtet e kontratës përkatëse do të konsiderohen të kualifikuar për të marrë një kontratë të tillë ose për marrjen e ftesës për tenderim. Dhe se, në asnjë rast, autoriteti kontraktues nuk duhet që të përfshijë, saktësojë ose përdorë kriteret e përzgjedhjes që bazohen në konsiderata të tjera përveç atyre të lejuara nga dispozitat e neneve 65-70 të këtij ligji. Andaj Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veprojnë kofom dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1,6,7, 27,28,51,59,60, 69 të LPP.

Autoritetit kontraktues “KOMUNA PRISHTINË” mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me inventar në Qendrat e Ndryshme Sociale -Ri-tender” me numër të prokurimit 616-25-6793-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Zv. Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

K

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - HM Home SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: